



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 22 prill 2025

Z. Zenun Elezaj, kryetar

Komuna e Klinës

Rr. "Abedin Rexha", nr. 31

32 000 Klinë

LETËR REKOMANDIMI

R. nr. 1103/2024

lidhur me cenimin e së drejtës për shkollim, mos ofrim i transportit për fëmijën me aftësi të kufizuara

I nderuari z. Elezaj,

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 14 tetor 2024 e pranoi ankesën e znj. Tahire Gashit (në tekstin e mëtejshme: ankuesja), parashtruar kundër Komunës së Klinës – Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), përkitazi me mospërfshirjen në listë për transportim në shkollë të fëmijës së saj me aftësi të kufizuara.

Sipas pohimeve të ankueses, Komuna e Klinës publikoi tenderin për transportimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara për në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta. Në listën e nxënësve, për të cilët do të organizohet transporti, nuk u përfshi fëmija i saj, i cili është nxënës në ShFMU "Motrat Qiriazit" në Klinë dhe mësimin e vijon me asistent mbështetës. Distanca që fëmija ndjek në një drejtim nga fshati Bokshiq, sipas ankueses, është mbi 9 kilometra.

Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të ankesës, ndërmori veprimet si në vijim:

Më 20 nëntor 2024 përfaqësuesja e Avokatit të Popullit, nga ankuesja u informua se po bisedonte me Komunën për mundësinë e sigurimit të transportit apo mbështetjes financiare.

Pasi ankuesja nuk mori vendim apo përgjigje nga Komuna lidhur me transportin e fëmijës, më 14 janar 2025 përfaqësuesja e Avokatit të Popullit, nëpërmjet telefonit kontaktoi drejtorin e DKA-së në Klinë. Ai pohoi se Komuna filloi procedura të veçanta prokurimi për sigurim të transportit për fëmijën e ankueses dhe, në momentin e përfundimit të procedurave, do t'i ofrohej mbështetje.

Avokati i Popullit më 15 janar 2025 iu drejtua kryetarit të Komunës së Klinës me kërkesë për informata lidhur me veprimet që planifikohen të ndërmerren.

Përfaqësuesja e Avokatit të Popullit më 26 janar 2025, nga ankuesja mori informatë se përmes e-mailit iu drejtua drejtorit të DKA-së, nga i cili edhe një herë kërkoi mbështetje për realizim të transportit për fëmijën e saj, gjithashtu e njoftoi se në ueb-faqen e Komunës nuk ka asnjë publikim apo njoftim lidhur me procedurat e prokurimit për transport të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Avokati i Popullit më 27 shkurt 2025 pranoi përgjigje nga Komuna në Klinë, me të cilën u informua se përkundër faktit që Komuna me kohë planifikoi dhe procedoi me tenderimin e kontratës së transportit për fëmijë me nevoja të veçanta, në kontratë u përfshinë vetëm nxënësit për të cilët pati kërkesa nga shkollat në kohën e planifikimit dhe të inicimit të procedurave, deri në fund të muajit gusht dhe fillim të muajit shtator 2025.

Tutje theksoi se ka një rast i cili nuk u përfshi në këtë kontratë për arsye të ndërrimit të vendbanimit, kërkesa për të cilin Komunës i erdhi në fund të muajit tetor dhe kufizimet e kontratës pamundësonin tejkalimin-shtimin e numrit të nxënësve.

Komuna gjithashtu njoftoi se përgatiti inicimin e një procedure të një kontrate të re ku do të përfshihen edhe nxënës të tjerë që kanë nevojë për transport, por pa dhënë detaje të qarta se kur pritet të përfundojë e gjithë procedura, e as një afat të përafërt se kur fëmija do të mund të përfitojë nga ky shërbim.

Më 18 mars 2024 përfaqësuesja e Avokatit të Popullit, nga ankuesja u njoftua se ende nuk iu ofrua zgjidhje nga DKA-ja për fëmijën e saj.

Dispozitat përkatëse ligjore lidhur me çështjen

Kushtetuta e Republikës së Kosovës¹, në nenin 21, paragrafi 1, përcakton: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.*” Kurse paragrafi 2 i këtij neni thotë: “*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.*”

Kushtetuta, në nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), përcakton: “*Të drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: [...] 7. Konventa për të Drejtat e Fëmijës. [...].*”

Neni 24 i Kushtetutës përcakton: “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit.*”

- (a) *Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim,*
- (b) *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. [...].*”

Kushtetuta, në nenin 47 [E Drejta për Arsimin], përcakton: “*1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike. 2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.*”

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Ndërsa Kushtetuta në nenin 50 (*Të Drejtat e Fëmijës*), përcakton: “*Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarrja qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.*”

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF), në nenin 2, paragrafi 2, përcakton: “*Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit...*”

Kurse neni 3 përcakton: “*Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.*”

KDF-ja, në nenin 28, përcakton: “*Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta në mënyrë të veçantë ata:*

U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme [...].”

KDF-ja, në nenin 28, përcakton detyrimin për shtetet palë që të angazhohen, pos të tjerash, që ta bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë, me qëllim që të arrihen synimet e arsimit të fëmijëve, në pajtim me nenin 29 të Konventës.

Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 17 / 16 shtator 2011, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: *Ligji për Arsimin*)², në nenin 3, paragrafi 3, përcakton: “*Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t’u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.*”

Neni 40, paragrafi 4, i Ligjit për Arsimin përcakton: “*Sipas vlerësimeve individuale profesionale, komunat sigurojnë transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me vështirësi në mësim që ndjekin mësimet në shkollë komunale.*”

Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, në nenin 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, përcakton: “*Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: “Arsim”.*”

Konstatim

Nga ato që u theksuan më lart, Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Klinës ka dështuar t’i përmbushte obligimet e saj ligjore në lidhje me sigurimin e transportit për fëmijën me aftësi të kufizuara. Ky mosveprim përbën shkelje të nenit 40, paragrafi 4, të Ligjit për

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

Arsimin, i cili përcakton se institucionet arsimore dhe autoritetet komunale duhet të ofrojnë mundësi të barabarta për fëmijët me aftësi të kufizuara, përfshirë transportin e përshtatshëm.

Avokati i Popullit konstaton se mosrealizimi i këtij shërbimi nga ana e Komunës përbën shkelje të së drejtës për arsim dhe barazi në qasje dhe është në kundërshtim edhe me KDF-në dhe me ligje të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare që mbrojnë dhe garantojnë të drejtën për arsim për çdo fëmijë.

Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”*; dhe sipas nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, duhet: *“Të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritete i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla.”*

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Komunës së Klinës:

- T’i ndërmarrë veprime për sigurimin e transportit të nevojshëm për fëmijën me aftësi të kufizuara.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (*“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”*), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit